

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KESHILLI GJYQESOR I KOSOVES**

Për Aktivitetin e Prokurimit - 328-23-6245-5-1-1

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Prizren- Faza e Parë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Pro & Co Group SH.P.K. & FLORING SHPK & SHKËMBI-GLLAREVË SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR. "Marigona Residenc" Llapnasellë, p.n. _____

(Adresa)

Graçanicë _____

10500 _____

(Vendi)

(Kodi postar)

+383 45 777 757 _____

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Kenan Emini _____

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

procogroupshpk@gmail.com _____

(Adresa elektronike)

22.08.2023 _____

(Data e parashtrimit të ankesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë – 23.06.2023

Hapja e ofertave - 24.07.2023

Njoftimi mbi vendimin e AK – 10.08.2023.

Kërkesa për rishqyrtim - 14.08.2023

Vendimi i AK – KGJK – 14.08.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet;

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Hapja publike është bërë me datë 29.11.2022. Gjatë hapjes publike nuk ishte evidentuar ndonjë parregullsi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet;

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Të pakënaqur me Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullte kohorë, me datë 14.08.2023, përmes kërkesës për ri shqyrtim kemi kërkuar Ri vlerësim të ofertave, duke prezantuar bazën ligjore dhe provat materiale.

Te njëjtën ditë me datën 14.08.2023 AK- KGJK, e refuzon kërkesën dhe le ne fuqi vendimin e AK-se , për dhënie të kontratës, përkundër shkeljeve ligjore dhe mos ofrimit të qasjes në dokumentacion publik.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi,
Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës,
Neni 11 Informatat Sekrete Afariste,
Neni 24 Zyrtaret e Prokurimit gjatë ushtrimit të AP-se,
Neni 25 Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit,
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve,
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës,
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale,
Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mos marrëveshjeve,
Neni 97, i RRPP-se,
Ligjit nr. 06/L081, për Qasje në Dokumente Publike,
Ligjit nr. 06/L-082, për Mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Te nderuar,

Komfor dispozitave të nenit 108/A, të LPP-se, GRUPI i Operatoreve Ekonomik **“Pro&Co Group” shpk & Florin G shpk & Shkëmbi**”, me datën 14.08.2023, ka paraqitur kërkesë për ri shqyrtim të vendimit, të datës. 10.08.2023, ku neve konsiderojë se AK – Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka rekomanduar për dhënie të kontratës operator ekonomik i cili ka prezantuar ofertë të pa përgjegjshme.

Pretendimet ankimore:

Grupi i OE-ve ankues, **“Pro&Co Group” shpk & Florin G shpk & Shkëmbi**”, pas pranimit

te njoftimit mbi rezultatet e aktivitetit te prokurimit, me datën 11.08.2023, ne kuptim te nenit 10 dhe 11, te LPP-se, kemi kërkuar qasje ne dokumentacion te Operatorit Ekonomik, te rekomanduar për dhënie te kontratës dhe atij te kualifikuar si te përgjegjshëm por te pa suksesshëm, megjithatë, përkundër konfirmimit për qasje neve nuk na lejohet as shikimi ne shkresa te këtyre ofertave dhe aq me pak kopjimi dhe marrja e shkresave, me arsyetimin se te njëjtat oferta si tërësi janë deklaruar sekret afarist.

Eshtë i çuditshme fakti, i shkeljeve esenciale te ligjit për prokurim publik, nr 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligje tjera, nga AK – KGJK, ku edhe ne vendimin e datës. 14.08.2023, potencohet se nuk është e drejt te japim ne USB ofertat dhe nuk ka bazë ligjore sipas LPP-se !

Ne vendim te se njëjtës kërkesë janë bashkangjitur si prova edhe Aneksi 3 i OE te rekomanduar për dhënie **EBK shpk**, ku përshkruhen qeshjet sekrete afariste.

- Paramasa dhe parallogaris.
- Gjendja ekonomike dhe financiare – Raporti nga banka dhe ATK
- Aftësia teknike dhe profesionale
- Lista e Projekteve (referencat, pranimet teknike dhe kontrata) stafi teknik profesional, makineria.

Neni 10 dhe 11, i LPP-se, përkatësisht nenit 7, i rregullores për prokurim publik, qarte trajton qeshjen e dokumentacionit afarist.

Neni 7, paragrafi 6 dhe 7 përcaktojnë:

- *Informacionet mund të klasifikohen si konfidenciale vetëm nëse:*
 - a. *Operatori Ekonomik, përveç se i identifikon ("markon") dokumentet si "sekret afarist" gjatë ngarkimit të tyre në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, i njëjti duhet të plotësojë Aneksin 3 të Dosjes së Tenderit "Kërkesa për sekret afarist".*
 - b. *Nëse Operatori Ekonomik konsideron që informatat e dorëzuara sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së të trajtohen nga Autoriteti Kontraktues si informata sekrete afariste në përputhje me nenin 11 të LPP-së, i njëjti duhet të shkarkojë nga sistemi Aneksin 3 "Kërkesa për sekret afarist", të plotësojë duke dhënë arsyetimet për secilin dokument të identifikuar si "sekret afarist", nënshkruaj dhe vulos aneksin, si dhe ta ngarkojë në sistem së bashku me dokumentet tjera të tenderit të tij.*

Është përgjegjësi e AK-së për të siguruar që pjesët të cilat janë deklaruar si sekret afarist nuk janë vënë në dispozicion Operatorëve të tjerë ekonomik.

Tek pjesa e arsyetimit te klasifikimit te ofertës si sekret afarist nuk ipet kurrë far deklarate mbi natyrën e demit material dhe arsyet pse duhet te konsiderohen shkresat e tilla si sekret,

por vetëm se është përshkruar numri i Ligjit për prokurim publik

I njëjti OE, Aneksin 3, e ka plotësuar si i vetëm, rrjedhimisht nuk është plotësuar i njëjti aneks edhe nga anëtarët e grupit, rrjedhimisht qasje nuk është ofertuar ne shkresa te anëtareve te krupit përkundër faktit se te njëjtit nuk i kane deklaruar shkresat e tyre si sekret afarist.

Edhe grupi tjetri i OE-ve, i kualifikuar si i përgjegjshëm por i pasuksesshëm, “Construmax shpk & Harst Group’ shpk, nuk kane dhëne kurrë far arsytimi lidhur me demet te cilat mund te shkaktohen me rastin e publikimit te shkresave.

Ngjashëm janë përshkruar dhe pjesët e deklaruara si sekret nga i njëjti grup janë:

- Paramasa dhe parallogaria
- Gjendja ekonomike dhe financiare – Raporti nga banka dhe ATK
- Aftësia teknike dhe profesionale
- Lista e Projekteve (referencat, pranimet teknike dhe kontrata) stafi teknik profesional, makineria.

Kompania jone *“Pro&Co Group” shpk & Florin G shpk & Shkëmbi*, përkundër mos ofrimit te qasjes është e bindur qe grupi i OE-ve te rekomanduar për dhënie te kontratës si dhe grupi i OE-ve “Construmax shpk & Harst Group” shpk, janë te pa përgjegjshëm lidhur me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional apo ftesin teknike dhe profesionale, siç e kane përshkruar ne aneksin 3, nuk kane prezantuar referenca dhe projekte sipas kërkesës dhe vlesës se përcaktuar ne dosje te tenderit, ngjashëm lidhur me stafit profesional, dhe makinerisë, vlerësojmë se nuk janë prezantuar dëshmi dhe prova përmes te cilave plotësohen kërkesat e kualifikimit, për kundër faktit se asnjëra nga këto shkresa ligjërish nuk mund te klasifikohen si sekret afarist, përjashto te dhënat personale. Po ashtu paramana dhe Parallogaria ne asnjë rrethane nuk mund te konsiderohet apo edhe te klasifikohet si sekret afarist, si e tille mund te ketë gabime ne kalkulim, gabime aritmetike apo edhe ndërhyrje fizike, te cilat AK – KGJK, nuk i ka prezantuar dhe nuk na ka lejuar qe te krahasojmë dhe krijojmë pretendime konkrete ankimore bazuar ne dispozitat ligjore.

Dispozita te nenit. 11, i LPP-se, paragrafi 3, pika 3.3 dhe 4, përcaktojnë qe: *“OE, i cili deklaron ofertën konfidenciale duhet te argumentoi përmes deklaratës me shkrim, ku domosdo duhet te vërtetohet se ndonjëri nga elementet e tenderit nuk është prone publike dhe te dhënat mbrohen dhe ne detaje do te arsyetohet konfidencialiteti apo sekreti ku zbulimi i tyre do te rezultonte me dëmtim material apo komercial te operatorit ekonomik”.*

Ndërsa paragrafi 4 i nenit 11, te LPP-se përcakton se, *“Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij*

neni, **do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti**, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkëngjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste”.

Kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, lista e stafit, kualifikimet e stafit, aspekti administrativ, aspekti teknik, paramasa - oferta financiare, formulari i tenderit, nuk mund të klasifikon si sekret afarist.

Ligjërisht sekret afarist mund të konsiderohen vetëm të dhënat personale, të AK - KGJK, në kuptim të paragrafit 4, të nenit 11, të LPP-se, është dashur ta përgatis versionin e pastruar të dokumenteve, ndaj OE-ve, të cilët i kanë deklaruar ofertat e tyre si të tilla. Rrjedhimisht me mos ofrim të qasjes ju si AK- KGJK, keni shkelur edhe dispozitat e nenit 10, të LPP-se, mjetet për promovimin e transparencës.

E drejta për qasje në dokumente publike është e drejte bazike madje e garantuar me Kushtetute të Republikës së Kosovës, sipas nenit 41:

1. Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.
2. Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.

Neni 97, i Rregullores për prokurim publik, nr. 001/2022, pika C), mos ofrimin e qasjes e klasifikon si shkelje të rënde të ligjit për prokurim publik.

- Neni 97.1 (RRPP) Shkelje të rënda konsiderohen:

c) Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumente zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Qasja e plote në dokumente publike është e garantuar edhe me nënparagrafin 3.2, të nenit 17 të ligjit nr. 06/L081, për Qasje në Dokumente Publike, si dhe me nenin 12, 13 dhe 14, të ligjit nr. 06/L-082, për Mbrojtjen e të dhënave personale.

Madje për këtë qeshje OSHP, ka nxjerr me dhjetëra vendime ku mohimi i qasjes në

dokumente publike është gjykuar ndryshe nga ju si AK .

Prandaj, gupi i OE-ve grupi i OE-ve ankues, "**Pro&Co Group**" shpk & **Florin G shpk & Shkëmbi**", bazuar provat faktet dhe dispozitave ligjore te larte cituara, kërkojmë qe Organi Shqyrtues i Prokurimit, fillimisht te autorizoi ekspert shqyrtues ne mënyrë qe ti vërtetoi dëshmitë e OE te rekomanduar për dhënie te kontratës dhe ati te renditur i dyti për nga oferta financiare, përkatësisht te konstatohet gjendja e ofertave, sa i përket kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional, lidhur me referencat, dhe kontratat e realizuara, stafi teknik, makineria si dhe te krahasohen paramanat dhe parallogarite, meqe nuk na është lejuar kurrë far qasje ne dokumentacion, ndërsa Paneli Shqyrtues, te nxjerrë:

V E N D I M

- **Te aprovoj** ne tërësi ankesën e bazuar,
- **Te kthehet lënda ne ri vlerësim** dhe te behet vlerësimi i ofertave siç përcaktohet me ligj te prokurimit publik.
- **Te aplikohen** dispozitat ligjore te nenit 25 paragrafi 8, dhe te njoftohet KRPP, me veprimet kundërligjore te konstatuara.

Ne te kundërtën Grupi i OE-ve ankues, përveç se do ti raportoi shkeljet ligjore ne OSHP, do te kërkojmë aplikimin e paragrafit 8 te nenit 25, te Ligjit për prokurim Publik, ndaj zyrtareve përgjegjës dhe do ta njoftojmë Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

Vërejtje: Përpos këtyre dëshmime AK posedon edhe të gjitha dëshmitë e nevojshme në dosjen e kësaj procedure të prokurimit nga të cilat mundet të vërtetohet pretendimet tona.